



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kacanik

01 Nr. 16-26480/14
Kaçanik, 10.09.2014

Në bazë të nenit 4 pika 1 dhe 2 lidhur me nenin 5 pika 2 të Ligjit nr. 03L-/087 të Ndërmarrjeve Publike, të nenin 23 Lista 2 e Ligjit nr. 04/L- 111 e Ligjit për Ndryshim Plotësimet e Ligjit nr. 03 L//087 për Ndërmarrjet Publike, të nenit 12 lidhur me nenin 17(f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me datë 10.09.2014, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale (NPK) "Stacioni i Autobusëve" SH.A- Kaçanik

I.

Me këtë Vendim formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale (NPK) "Stacioni i Autobusëve". Sh. A- Kaçanik.

II.

Komisioni Komunal i Aksionareve për Ndërmarrjen Publike Komunale "Stacioni i Autobusëve", SH.A- Kaçanik, në përputhje me ligjet në fuqi do të ketë 3 anëtarë: 1 (një) anëtar emërohet nga Kryetari i Komunës dhe 2 (dy) anëtarë emërohen nga Kuvendi i Komunës.

III.

Anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve, të emëruar nga Kuvendi i Komunës janë:

1. Sabedin Vishi, anëtar i KK nga subjekti politik i PDK, dhe
2. Hajdar Loku, anëtar i KK nga subjekti politik i AAK.

IV.

Detyrat e Komisionit Komunal të Aksionarëve janë të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe në Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

V.

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikqyrës-MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

VI.

Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.

VII.

Me këtë vendim njoftohen: Anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë (përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante) dhe Arkivi



Kryesuesi i Kuvendit,
Xhelal Gashi